

URDHËR
Nr. 641, datë 29.10.2025

PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 619, DATË 16.10.2025, TË MINISTRIT TË DREJTËSISË, “PËR AUTORIZIMIN DHE DELEGIMIN E DISA KOMPETENCAVE/AUTORITETIT TË MINISTRIT TË DREJTËSISË, ZËVENDËSMINISTRIT TË DREJTËSISË, znj. ELONA HOXHA”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 619, datë 16.10.2025, të ministrit të Drejtësisë, “Për autorizimin dhe delegimin e disa kompetencave/autoritetit të ministrit të Drejtësisë, zëvendësministrit të Drejtësisë, znj. Elona Hoxha”, bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 2, togfjalëshi “institucionet penitenciare dhe institucionet në varësi të ministrit të Drejtësisë” zëvendësohet me togfjalëshin “institucionet në varësi të ministrit të Drejtësisë, me përjashtim të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve,”;

b) Në pikën 4, togfjalëshi “hartimit, zbatimit dhe/ose ndryshimit të akteve ligjore dhe nënligjore të paketës penitenciare dhe zbatimit të rekomandimeve të Komitetit të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës, zhvillimit të programeve të punësimit për të dënuarit me burgim,” shfuqizohet.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Elona Hoxha, për zbatimin këtij urdhri.

3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Besfort Lamallari